

Forumi i Politikave të Integritimit monitoron nga afër procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe institucionet e përfshira në të, duke u përqendruar kryesisht në koordinimin ndërinstytucional ndërmjet njërive dhe dokumenteve dhe raporteve të tyre ligjore. Treguesit e monitorimit dhe rregullat metodologjike përfshijnë aktet normative dhe/ose legjislative të miratuara; aktivitetet e kryera (numri i takimeve, plan-veprimeve, raportet, strategjitë për të adresuar mangësitë e identifikuara nga raporti i KE, etj.); fazën e zhvillimit paraprakisht të instrumenteve; si dhe shqyrtimin institucional dhe publik të rezultateve të arritura.

RUAJTJA E NATYRËS DHE RËNDËSIA E SAJ NË PROCESIN E INTEGRIMIT

EU Policy Hub

HYRJE

Shqipëria mbart një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore të Evropës dhe përfaqëson një ndër vendet e para në kontinent për sa i përket sipërfaqes me vlera të larta natyrore në raport me sipërfaqen totale të vendit. Ruajtja e natyrës, ndonëse nuk ka marrë vëmendjen e duhur në tërësinë e prioritetëve të integritimit, përfaqëson një kusht të rëndësishëm në kuadër të këtij procesi. Në sferën e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit, Shqipëria ka detyrim të identifikojë dhe mbrojë zonat e trashëgimisë natyrore me interes të lartë ruajtjeje për Bashkimin Evropian, nëpërmjet zbatimit të dy direktivave evropiane, përkatësisht [Direktivës së Shpendëve](#) dhe [Direktivës së Habitaveve](#). Përbushja e këtij detyrimi ka të bëjë kryesisht me njehsimin e legjislacionit kombëtar të ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit me atë të Bashkimit Evropian, nëpërmjet transpozimit të direktivave dhe zbatimit të tyre.

Ky dokument i shkurtër politikash ka për qëllim të theksojë rëndësinë e ruajtjes dhe mirëmenaxhimit të trashëgimisë natyrore të Shqipërisë, bazuar në

standardet dhe direktivat e Bashkimit Evropian, si domosdoshmëri në procesin e integritimit. Në vijim, qëllimi është të nxirren në pah problematikat konkrete në zbatimin e *acquis* në fushën e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit në Shqipëri, si dhe të theksohen rekomandimet përkatëse, në mënyrë që të shmanget çdo cenim i mundshëm i procesit të integritimit të vendit në Bashkimin Evropian.

TRASHËGIMIA NATYRORE E SHQIPËRISË DHE RËNDËSIA E SAJ PËR BASHKIMIN EVROPIAN

Shqipëria mbart një biodiversitet tejet të pasur, marrë për bazë sipërfaqen e vogël në të cilën shtrihet. Kjo pasuri është fryt i larmisë së madhe të formave të relievit, pejsazheve dhe habitateve natyrore që karakterizojnë vendin. Për Shqipërinë është raportuar një [numër prej 7233 taksonesh bimore dhe përlllogaritet se vendi përmban rreth 32% të diversitetit llojor të florës](#) së Evropës. Në vijim, Shqipëria dallohet gjithashtu për një diversitet të lartë faunistik, me një numër të konfirmuar prej [rreth 5450 llojesh të grupeve të ndryshme të faunës, ndër të cilat rreth 110 lloje janë të rralla](#) dhe me interes të lartë ruajtjeje në nivel global.

Për ruajtjen e larmisë biologjike në vend është krijuar [Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura](#), i cili përfshin një numër prej 800 zonash të tilla (përfshirë këtu edhe monumentet e natyrës), të cilat zënë një sipërfaqe prej rreth 16% të territorit të vendit.

Një pjesë e sipërfaqes së Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura, si edhe një numër i konsiderueshëm ekosistemesh të tjera me vlera të larta natyrore, janë pjesë e rrjeteve të ndryshme ekologjike ndërkombëtare. Liqenet e Prespës, Laguna e Karavastasë, Liqeni i Butrintit – Kanali i Çukës – Kepi i Stillos, dhe Liqeni i Shkodrës – Lumi Buna janë 4 ligatinat e cilësuar me rëndësi ndërkombëtare, të njohura nga [konventa RAMSAR](#), të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në vitin 1996. Zona ndërkufitare Liqeni i Ohrit – Liqenet e Prespës është shpallur nga UNESCO si [Rezervë Biosfrike](#). Gjithashtu, zona e Lumit të Gashit dhe zona e pyjeve parësore të Rrajcës (zonë qendrore e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë) janë të përfshira sërish nga UNESCO, në [listën e Trashëgimisë Botërore të Pyjeve të Ahut](#). Zonat ndërkufitare të përshkuara nga ish-gardhi i hekurt (kloni) i periudhës së komunizmit janë tashmë të përfshira në [Rrjetin e Brezit të Gjelbër të Evropës](#). Në vijim, Organizata Ndërkombëtare për Ruajtjen e Shpendëve (BirdLife International) ka njohur një numër prej [16 zonash të rëndësishme për shpendët](#) në nivel global, të cilat, përmenden në ligjin e ri të zonave të mbrojtura ([Ligj 81/2017](#)) si ["Zona të Mbrojtura me Interes Ndërkombëtar"](#). Më tej, [Fondi i Partneritetit për Ekosistemet e Kërcënuara](#) (CEPF), aktualisht një ndër konsorciumet më të mëdhenj për ruajtjen e natyrës në botë, nëpërmjet një procesi

gjithëpërfshirës bazuar në të dhëna shkencore, ka njohur në Shqipëri një numër prej 29 Zonash Kyç për Biodiversitetin (ZKB) në nivel global.

Së fundmi, por ndër të parët për nga rëndësia, është edhe [Rrjeti Emerald i përbërë prej 25 zonash të propozuara nga Shqipëria](#) në kuadër të detyrimeve që burojnë nga ratifikimi Konvetës së Bernës dhe të miratuara nga kjo e fundit në dhjetor 2012. [Rrjeti Emerald](#) përfshin Zona me Interes të Veçantë Ruajtjeje (ASCI) të identifikuar në vendet të cilat kanë ratifikuar Konventën e Bernës, për të përmbushur detyrimet që burojnë nga kjo e fundit dhe janë simotra të rrjetit ekologjik Natura 2000 të Bashkimit Evropian.


Më poshtë gjendet një hartë që përmbledh të gjitha sipërfaqet e lartpërmendura.¹ Sikurse shihet në hartë, më shumë se gjysma e sipërfaqes së vendit, ekzaktësisht 53.4% (15342 km²) është njohur si zonë Kyç për Biodiversitetin në nivel global (nga CEPF) dhe nëse do të shtonim diferencën e sipërfaqes së mbetur, e cila përfshihet në Rrjetin e Zonave të Mbrojtura dhe rrjetet e tjera ekologjike, sipërfaqja shkon në rreth 60% të sipërfaqes totale të vendit². Shifër që tregon qartazi se [Shqipëria është një ndër vendet e para në Evropë për sa i përket sipërfaqes me vlera të larta natyrore](#) (të njohur nga rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare ekologjike) krahasuar me sipërfaqen totale të vendit.

Harta 1: Zonat me vlera të larta natyrore në Shqipëri të njohura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

¹ Harta është përgatitur enkas për këtë dokument të shkurtër politikash, duke shfrytëzuar shapefile-t e zonave përkatëse. Zonat të cilat janë përmendur në tekst por nuk janë pasqyruar në

legjendën e hartës, përfshihen brenda kufijve të zonave të cilat janë pasqyruar në legjendë.

² Shifra është përlogaritur nëpërmjet mbledhjes së sipërfaqeve të zonave të përmendura (shapefile-ve të tyre nëpërmjet programit QGIS).



Burimi: Përpunim i autorit

KONTEKSTI I ZBATIMIT TË ACQUIS PËR RUAJTJEN E NATYRËS DHE BIODIVERSITETIT NË SHQIPËRI DHE PROBLEMATIKAT PËRKATËSE

Në kuadër të procesit të integrimit të vendit në Bashkimin Evropian, në sferën e ruajtjes së mjedisit dhe përkatësisht në aspektin e ruajtjes së natyrës, Shqipëria ka si detyrë njehsimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së nëpërmjet transpozimit të Direktivave Evropiane të Shpendëve dhe Habitaveve. [Direktiva e Shpendëve](#) ka për qëllim ruajtjen e shpendëve të egër dhe habitaveve të tyre në territorin e Bashkimit Evropian nëpërmjet identifikimit dhe shpalljes së "Zonave të Rëndësisë së Veçantë" (SPA - Special Protection Area). Në anën tjetër, [Direktiva e Habitaveve](#) ka për qëllim ruajtjen e një numri të madh llojesh të bimëve ose kafshëve të egra të

cilat janë të rralla, të kërcënuara ose endemike. Kjo direktivë siguron gjithashtu mbrojtjen e rreth 200 llojeve të ndryshme të habitaveve të rralla. Zbatimi i Direktivës së Habitaveve kërkon identifikimin dhe shpalljen e "Zonave të Veçanta të Ruajtjes" (SAC - Special Areas of Conservation). Zonat e Rëndësisë së Veçantë dhe Zonat e Veçanta të Ruajtjes përbëjnë rrjetin e zonave të mbrojtura të Bashkimit Evropian të quajtur Natura 2000.

Përsa i përket njehsimit të legjislacionit për ruajtjen e natyrës dhe biodiversitetit, [në dokumentin e politikave strategjike për ruajtjen e biodiversitetit](#) raportohet se Shqipëria ka bërë një progres i vlerësuar në masën 85%. Më tej, në janar 2017, u miratua nga parlamenti [edhe ligji ri i Zonave të Mbrojtura nr. 81/2017](#), i cili përfaqëson njehsimin në masë të të gjerë legjislacionin kombëtar për ruajtjen e biodiversitetit me atë të BE-së. Në këtë ligj i kushtohet një seksion i veçantë (përkatësisht seksioni V) zonave të mbrojtura me interes ndërkombëtar dhe në veçanti zonave Natura 2000.

Nga sa më lart, kuptohet se një prej detyrimeve kryesore në fushën e ruajtjes së biodiversitetit, ai i njehsimit të legjislacionit kombëtar me atë evropian, është pothuajse i përfunduar. Por çfarë po ndodh me detyrimin e dytë, njësoj të rëndësishëm: atë të identifikimit të zonave Natura 2000 në Shqipëri? Sipas [raportit të fundit të Komisionit Evropian](#), brenda fundit të vitit 2017, pritet të përfundojë vlerësimi i pesë zonave të zgjedhura, në bazë të kriterëve të Direktivës së Habitaveve. Nga ky pohim, kuptohet qartazi se: së pari, procesi i identifikimit të zonave, të cilat plotësojnë kriteret e Direktivës së Shpendëve dhe Direktivës së Habitaveve, është në fazat fillestare; dhe së dyti, ky koha e finalizimit të listës së plotë të zonave Natura 2000 është e largët. Pse?

Procesi i identifikimit të rrjetit Natura 2000 kërkon një vlerësim të përgjithshëm dhe të kujdeshëm të gjithë territorit të vendit, bazuar në një qasje rigoroze shkencore. Aktualisht, nëpërmjet një projekti prej 3.5 vitesh, po bëhet vlerësimi vetëm për 5 zona të përzgjedhura. Ky vlerësim po realizohet në kuadër të projektit IPA 2013 "[Zonat e Mbrojtura Natura 2000 në Shqipëri](#)", i cili po zbatohet që prej vitit 2015. Ndonëse titulli i këtij projekti të krijon përshtypjen se qëllimi kryesor është identifikimi i zonave të denja për të qënë pjesë e rrjetit Natura 2000, objektivi kryesor është pothuajse krejtësisht i ndryshëm. Kjo në mënyrë të drejtpërdrejtë të krijon shqetësimin dhe le të kuptohet se ky proces po nënvlerësohet dhe dita e finalizimit të tij është e largët. Objektivi kryesor i këtij projekti IPA, ndryshe nga çfarë pritej dhe çfarë duhet të ishte (identifikimi i zonave Natura 2000), është forcimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura në Shqipëri nëpërmjet zbatimit të planeve të menaxhimit. Në kuadër të këtij projekti vëmendja është e përqëndruar vetëm në një pjesë të rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura.

Zbatimi i procesit Natura 2000 kërkon vlerësimin e të gjithë territorit të vendit dhe jo përqendrimin e punës vetëm në Rrjetin Kombëtar të Zonave të Mbrojtura. Zbatimi i qasjes së duhur do të mundësonte identifikimin e zonave me interes të lartë ruajtje për Bashkimin Evropian, bazuar në Direktivat Shpendëve dhe Habitave. Për shembull, siç është rasti i zonës së Luginës së Lumit Drino në qarkun e Gjirokastrës apo zonës së Malit të Munellës që shtrihet në qarqet Lezhë, Shkodër, Kukës. Në të parën, në një ditë të vetme grumbullohet rreth [2% e popullatës globale](#) të Sokolit të vogël (*Falco*

naummani), lloj me interes të lartë ruajtje në nivel evropian (i listuar në [Aneksin I të Direktivës Evropiane së Shpendëve](#)), ndërsa në të dytën riprodhohet rreth 20% të popullatës globale të Rrëqebullit të ballkanit (*Lynx lynx balcanicus*)³. Asnjë prej këtyre zonave nuk janë pjesë e Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura, ashtu sikurse mund të ketë shumë zona të tjera me vlera të larta natyrore në vend për të cilat nuk ka ende dijeni. Kjo për shkak të mungesës së të dhënave dhe mungesës së mundësive për t'i grumbulluar ato nëpërmjet metodave të mirëfillta shkencore.

Fondet IPA që i jepen një vendi kandidat të mundshëm, për zbatimin e procesit Natura 2000, përfaqësojnë një mundësi unike për vendin përfitues, për të grumbulluar të dhëna mbi komponentët e biodiversitetit bazuar në metoda rigoroze shkencore dhe në këtë mënyrë të mundësohet identifikimi i zonave me interes të lartë ruajtje.

Qasja e zbatimit aktual të procesit Natura 2000 në Shqipëri nuk e mundëson arritjen synimit përkatës. Hartimi i Listës Paraprake të Zonave Natura 2000 në Shqipëri është renditur si objektivi i dytë i projektit ose procesit të sipërpërmendur "Zonat e Mbrojtura Natura 2000 në Shqipëri". Pyetjet që lindin këtu janë: kur do të mund të përgatitet lista finale dhe si do të arrihet kjo (identifikimi i zonave Natura 2000)?

Marrë në konsideratë që projekti IPA i sipërpërmendur fokusohet vetëm në rrjetin kombëtar të zonave të mbrojtura dhe pjesa tjetër e territorit mbetet e pambluar, për pyetjen e dytë: një mënyrë është grumbullimi i të dhënave dytësore. Mbi bazën e të dhënave dytësore të besueshme, normalisht, mund të hartohet

³ PPNEA (2017), Vlerësimi i biodiversitetit në zonën e malit të Munellës dhe justifikimi për mbrojtjen e tij. Raport vrojtues. I padisponueshëm online.

një listë paraprake e zonave të mundshme Natura 2000 për vendin. Megjithatë, pyetjet kryesore që ngrihen në këtë pikë janë: (i) Sa të plota dhe të besueshme janë këto të dhëna që të mund të shërbejnë për këtë qëllim; dhe (2) A ekzistojnë të dhëna të kësaj natyre për të gjitha zonat e mundshme që duhet të jenë objekt vlerësimi? Padyshim përgjigjja për të paktën pyetjen e dytë është "jo".

Mënyra e dytë për të arritur synimin (finalizimin e listës së zonave Natura 2000 të vendit) është të kërkohet një fond tjetër i njëjtë IPA dhe të zbatohet një proces rigoroz vlerësimi. Sërish edhe në këtë pikë, ngrihen dy pyetje kryesore: (i) A është e mundur kjo në një situatë kur është ezauruar një fond i dedikuar për këtë qëllim për Shqipërinë?; dhe (ii) Kur mund të jepet sërish një fond i tillë? Nga këto pyetje dhe nga sa përshkruhet më lart, e pakta që kuptohet është vonesa në zbatimin e procesit Natura 2000 dhe më tej pasiguria në zbatimin si duhet të tij.

Realizimi i suksesshëm i procesit Natura 2000 dhe në kohën e duhur, përfaqëson një ndër arritjet më të mëdha që vendi mund sigurojë në fushën e ruajtjes dhe menaxhimit të qëndrueshëm të natyrës dhe biodiversitetit. Integrimi në BE përfaqëson një ndër prioritetet e para të vendit. Njëherësh që Shqipëria identifikon dhe miraton listën e zonave të mundshme Natura 2000, atëherë është e detyruar që në kuadër të procesit të integritimit, të mbrojë dhe menaxhojë këto zona bazuar në rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Në kontekstin shqiptar, kjo do të krijonte "ombrellën" më të mirë për ruajtjen e këtyre zonave nga kërcënimet e shumta dhe serioze që u kanosen. Kësisoj, përmbushen edhe detyrimet që burojnë nga [Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit](#) në fushën e ruajtjes së natyrës. Njohja e

këtyre sipërfaqeve si zona të mundshme Natura 2000 në mënyrë të drejtpërdrejtë siguron një mbrojtje dhe menaxhim më të mirë, gjithashtu edhe si pasojë e përfitimeve (si p.sh. grante të BE-së për ruajtjen e natyrës) që iu mundëson ky status.

PROBLEMET E RUAJTJES DHE MENAXHIMIT TË ZONAVE ME INTERES TË VEÇANTË RUAJTJE NË SHQIPËRI

Meqenëse procesi i identifikimit të zonave Natura 2000 në Shqipëri është ende në zhvillim dhe finalizimi i plotë i këtij procesi ka gjasë të vonohet dhe të paktën 3-4 vite të tjera⁴, atëherë shihet me vend që Rrjeti i Zonave Emerald të trajtohet me vëmendje të veçantë.

Rrjeti Emerald përfshin Zona me Interes të Veçantë Ruajtjeje të identifikuar në vendet të cilat kanë ratifikuar "Konventën për Ruajtjen e Florës dhe Faunës së Egër dhe Mjedisit Natyror të Evropës" ose siç njihet ndryshe "Konventa e Bernës". Njohja dhe raportimi i këtyre zonave pranë "Konventës së Bernës" është realizuar për të përmbushur detyrimet e çdo vendi anëtar ndaj kësaj të fundit.

Rrjeti i zonave Natura 2000 në këtë aspekt nuk është gjë tjetër veçse kontribut i përbashkët i vendeve anëtare të Bashkimit Evropian për të përmbushur detyrimet që burojnë nga Konventa e Bernës. Në këtë logjikë, për sa kohë identifikimi i zonave Natura 2000 të jetë në proces zhvillimi është pikërisht rrjeti Emerald ndaj të cilit duhen zbatuar rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Rrjeti i Zonave Emerald, ndonëse i pari për nga rëndësia (të paktën në kuadër të procesit të integritimit), fatkeqsisht është i fundit për nga vëmendja me të cilën

⁴ Kohëzgjatja e projektit IPA 2013 që është aktualisht duke u zbatuar në Shqipëri.

trajtohet. Zonat e Rrjetit Emerald përftojnë një nivel vëmendjeje të veçantë vetëm në ato raste kur e gjitha, ose një pjesë e sipërfaqes së tyre ndodhet në të njëjtën kohë brenda kufijve të rrjetit kombëtar të Zonave të Mbrojtura, por edhe kjo jo domosdoshmërisht. Sipërfaqja e rrjetit Emerald, e cila shtrihet jashtë rrjetit të zonave të mbrojtura, trajtohet si çdo pjesë e zakonshme e territorit. Këto zona janë pothuajse tërësisht jashtë qasjes së menaxhimit të studiuar, monitorimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në shumë raste këto zona kërcënohen nga një numër i madh i problemeve mjedisore. Ndër më kryesoret mund të përmenden: (i) gjuetia; (ii) prerja e sipërfaqeve pyjore; (iii) zjarret; (iv) ndotja e ujit dhe peizazhit; (v) ndërtimi i hidrocentraleve dhe objekteve të tjera. Këto aktivitete kanë shkaktuar në zonat Emerald degradim të habitateve natyrore dhe humbje të biodiversitetit, duke përfshirë edhe lloje me interes të lartë ruajtjeje për Bashkimin Evropian të listuara në anekset e Direktivave të Shpendëve dhe Habitaveve.

Aktivitetet e sipërpërmendura mund të jenë të paligjshme, ashtu sikurse mund të jenë edhe të ligjshme. Përgjithësisht për aktivitetet e paligjshme raportohet vullneti për t'i kontrolluar, duke prezantuar masat konkrete dhe statistikat krahasuese të vlerësimit të intensitetit të fenomenit nga viti në vit. Ndërsa aktivitetet e ligjshme nga shteti (në mospërputhje me direktivat përkatëse të BE-së) janë teorikisht dhe praktikisht të pajustificueshme dhe faktorë të drejtpërdrejtë që çenojnë procesin e integritimit.

Jo në pak raste janë prezantuar plane të papërshtatshme zhvillimi apo investimi në zona të caktuara të Rrjetit Emerald, të cilat në të njëjtën kohë janë edhe pjesë e

rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura. Këto plane konsistojnë në tjetërsimin e sipërfaqeve të mëdha natyrore brenda këtyre zonave për ndërtimin e resorteve të turizmit masiv. Prezantimi i planeve të urbanizimit të disa prej zonave më të mira, simbol të natyrës shqiptare, sikurse është rasti i Peisazhit të Mbrojtur Vjosë – Nartë dhe rasti i fundit dhe më i freskët është ai i Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta që e ilustron më së miri këtë pohim.

Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta është zona simbol e natyrës shqiptare dhe ligatina më e rëndësishme për shpendët në Adriatikun e jugut. Kjo zonë është habitat për më shumë se [245 lloje shpendësh](#) dhe përfaqëson zonën me diversitet më të lartë avifaunistik në vend. Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta është habitat për të vetmen koloni të pelikanit kaçurrel (*Pelecanus crispus*) në Shqipëri, i cili është lloj me interes të lartë ruajtjeje në nivel global, duke mbajtur statusin "i përkeqësuar" sipas Listës së Kuqe të Llojeve të Rrezikuara të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Pelikani kaçurrel (*Pelecanus crispus*) është gjithashtu lloj me interes të lartë ruajtjeje për Bashkimin Evropian dhe është listuar në Direktivën Evropiane të Shpendëve. Së fundmi, por jo për nga rëndësia, ky lloj është me interes të lartë ruajtjeje gjithashtu në rang kombëtar, pasi është listuar në [listë e Kuqe të Florës dhe Faunës së Shqipërisë](#), duke mbajtur statusin "I rrezikuar në mënyrë kritike". Në këtë zonë, gjendet [rreth 2% e popullatës evropiane](#) të Pelikanit Kaçurrel ose 52 çifte folezuese⁵. Vetëm duke marrë në konsideratë këtë fakt, kuptohet rëndësia e madhe e kësaj zone për trashëgiminë natyrore të Evropës. Në këtë zonë gjendet gjithashtu [kolonia e vetme e çafkave në](#)

⁵ Qendra për Ruajtjen dhe Mbrojtjen e Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA), të dhëna të papublikuara.

[Shqipëri](#). Në këtë koloni janë konfirmuar si folezues: (i) karabullaku i vogël (*Phalacrocorax pygmeus*); (ii) çafka e natës (*Nycticorax nycticorax*); (iii) çafka e verdhë (*Ardeola ralloides*), si dhe me shumë gjasë mund të folezojnë edhe (iv) çafka e bardhë e vogël (*Egretta garzetta*); (v) çafka e bardhë e madhe (*Egretta alba*); (vi) çafka e përhimë (*Ardea cinerea*), si dhe (vi) karabullaku i madh (*Phalacrocorax carbo*). Të gjitha këto lloje janë me interes të lartë ruajtjeje për Bashkimin Evropian dhe janë të listuara në Direktivën e Shpendëve. Për shkak të këtyre vlerave, kjo zonë është pjesë e të gjithë rrjeteve ekologjike në të cilat aderon Shqipëria dhe ndër zonat e sigurta Natura 2000 në të ardhmen.

Në fillim të 2017 u prezantua [projekti "Divjaka Resort Albania"](#), në kuadër të të cilit u organizuan edhe disa dëgjesa publike me grupet e ndryshme të interesit, përfshirë këtu organizatat e shoqërisë civile dhe banorët vendas përreth zonës në të cilën parashikohet të ndërtohet projekti. Ky projekt konsiston në ndërtimin e një kompleksi të turizmit masiv dhe elitare në brendësi të kufijve të Parkut Kombëtar Divjakë-Karavasta, e cila në të njëjtën kohë është pjesë e Rrjetit të zonave Emerald. Në kuadër të këtij projekti parashikohet të tjetërsohet një sipërfaqe natyrore totale prej 3342 ha, ku përfshihen 200 ha plazh, 1050 ha sipërfaqe pyjore, 820 ha tokë bujqësore dhe 1270 ha sipërfaqe lagunore. Projekti parashikohet të shtrihet në [një linjë bregdetare prej 12 km, ku do të ndërtohet një resort turistik prej rreth 90 ha, 370 vila, 2400 apartamente dhe hotele me një kapacitet total prej 4300 shtretërish](#).

Nuk mund të mohohet se një projekt i tillë ka një ndikim domethënës në habitatin natyror, pejsazhin dhe popullatat e llojeve me interes të lartë ruajtjeje në nivel kombëtar, evropian dhe global. Është

vërtetuar tashmë se [shkaku kryesor për rënien e popullatës së pelikanit kaçurrel në kufijtë e "i rrezikuar për zhdukje" është shqetësimi dhe shkatërrimi i habitatit](#). Puna e realizuar përgjatë pak viteve të fundit për eliminimin e kërcënimeve të sipërpërmendura mundësoi rimëkëmbjen e popullatës së pelikanit kaçurrel dhe [zbritjen e kategorisë së kërcënimit në nivel global nga "I rrezikuar" në të "Përkeqsuar"](#). Eliminimi i këtyre kërcënimeve edhe në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta, gjithashtu rezultoi në [pothuajse dyfishimin e çifteve në koloninë e vetme të këtij lloji në Shqipëri](#) vetëm në pak vite. Fatkeqisht zbatimi i projektit në fjalë nuk mund kurrsesi të shmangë as shkatërrimin e habitatit dhe as shqetësimin. Të dy këto kërcënime manifestohen gjatë fazës së ndërtimit ashtu sikurse edhe gjatë fazës së zbatimit. Shkatërrimi i habitatit përfaqësohet me një fakt fare të thjeshtë, atë të tjetërsimit ose urbanizimit të pejsazhit natyror, ndërsa shqetësimi buron nga prania e shtuar e njerëzve, makinerive dhe pajisjeve të ndërtimit. Risjellja e këtyre kërcënimeve në zonë mund të jetë faktor për zhdukjen e kolonisë së pelikanit dhe kolonisë së çafkave dhe shkatërrimin e një zone të sigurtë Natura 2000 në të ardhmen.

Ligjërimi dhe lejimi i planeve apo projekteve të kësaj natyre, të cilat konsistojnë në tjetërsimin e sipërfaqeve të konsiderueshme natyrore brenda Zonave Emerald dhe si rrjedhim kërcënimin e habitateve dhe llojeve, përbën shkelje të hapur të rregullave dhe standardeve të BE-së për ruajtjen dhe menaxhimin e këtyre zonave. Një pjesë e mirë e vendeve të Bashkimit Evropian kanë qenë pre e masave ndëshkuese si pasojë e shkeljes së këtyre direktivave. Organizata *BirdLife International* në vitin 2004 përgatiti një [raport përmbledhës të rasteve të dhunimit të Direktivës së Shpendëve të ndëshkuara](#)

[nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë](#). Një ndër rastet më të afërt me vendin tonë, si në aspektin gjeografik ashtu edhe në atë të problematikës është [rasti i Bullgarisë](#). Në tetor 2009, Komisioni Evropian i dërgoi katër paralajmërime Bullgarisë për shkelje të Direktivave Evropiane të Shpendëve dhe Habitave, në kuadër të projekteve të ngjashme. Një ndër këto projekte konsistonte në ndërtimin e një qendre për ski në zonën e mbrojtur të Maleve Pirin. Ky projekt ishte miratuar pjesërisht nga qeveria bullgare përpara vlerësimit rigoroz të ndikimit në llojet dhe habitatet me interes të lartë ruajtje për Bashkimin Evropian.

Në kuadër të procesit të integritimit, Shqipëria ka për detyrë të bëjë progres në njehsimin e legjislacionit dhe standardeve me ato të Bashkimit Evropian dhe të garantojë zbatimin e tyre. Jetësimi i projekteve të tilla përfaqëson raste të mirëfillta regresi dhe shkakton kosto në procesin e integritimit.

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Shqipëria mbart një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore të Evropës, për të cilën në kuadër të procesit të integritimit është e detyruar ta mbrojë dhe mirëmenaxhojë në bazë të rregullave dhe direktivave të Bashkimit Evropian. Analiza e zhvilluar në kuadër të këtij dokumenti të shkurtër politikash konstaton probleme dhe vonesa në përmbushjen e detyrimeve në kuadër të procesit të integritimit, në sferën e ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit. Nëse këto probleme nuk trajtohen me vëmendjen e duhur, vendi rrezikon të përballet me pasoja, të cilat së pari dhe më e rëndësishmja çenojnë procesin e integritimit, njëkohësisht prioritetin kryesor kombëtar, për të cilin çdo qeveri ka marrë angazhim përballë

qytetarëve të këtij vendi. Në mënyrë që këto pasoja të shmangen është tepër e rëndësishme që **qeveria shqiptare** të marrë në konsideratë dhe të zbatojë të paktën tre **masa kryesore**:

- a) Së pari, të përshejtojnë dhe finalizojë procesin e njehsimit të plotë të legjislacionit kombëtar për ruajtjen e natyrës me atë të Bashkimit Evropian nëpërmjet transpozimit të qartë të Direktivave Evropiane të Shpendëve dhe Habitave.
- b) Së dyti, të realizojë me cilësi të lartë dhe në kohë procesin e identifikimit të zonave të mundshme Natura 2000, nëpërmjet zbatimit rigoroz të dy direktivave evropiane në fjalë. Përqendrimi i vëmendjes vetëm në njërin prej këtyre direktivave është një mangësi krejtësisht e pajustificueshme në këtë proces dhe kursesi nuk mund të garantojë një rezultat të plotë dhe të besueshëm.
- c) Së fundmi, deri në finalizimin e listës së zonave Natura 2000, zonat e Rrjetit Emerald duhen trajtuar si të tilla dhe duhen menaxhuar në përputhje me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Qeveria shqiptare (e cila vetë i ka propozuar Konventës së Bernës listën e zonave Emerald) duhet të tregojë kujdes të veçantë, në mënyrë që të mos ligjërojë apo lejojë projekte të cilat bien ndesh me rregullat dhe standardet e Bashkimit Evropian. Nëse habitatet apo llojet me interes të lartë ruajtje për Bashkimin Evropian shkatërrohen apo çënohen, si pasojë e projekteve apo investimeve të lejuara nga qeveria shqiptare, atëherë kjo përbën shkelje të pajustificueshme të kushteve të anëtarësimit dhe cënim të drejtpërdrejtë të procesit të integritimit.